

Treguesit demografikë

Vjetore 2022 dhe tremujori I – 2023


Tiranë, më 24 Maj 2023: Në vitin 2022, shtesa natyrore e popullsisë rezulton pozitive me 690 lindje më shumë se sa vdekje, duke iu rikthyer trendit pozitiv para pandemisë.

Gjatë vitit 2022 lindën 24.688 foshnja, duke shënuar një rënie me 9,3 %, krahasuar me një vit më parë, ndërsa numri i vdekjeve ishte 23.998 persona, duke shënuar një rënie me 21,3 %, krahasuar me një vit më parë.

Pesë qarqe të vendit shënuan shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në shtatë qarqet e tjera shtesa natyrore e popullsisë ishte negative.

Qarku me shtesën natyrore më të lartë ishte Tirana, me 3.262 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët ishte Korça, me 959 vdekje më shumë se sa lindje.

Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë



** Të dhëna janë paraprake


Numri i lindjeve për tremujorin e parë 2023 është 5.164, duke shënuar një rënie me 16,9 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022, ndërsa numri i vdekjeve është 5.557, duke shënuar një rënie prej 31,6 %, krahasuar me tremujorin e parë 2022.

Shtesa natyrore e popullsisë, në tremujorin e parë 2023 regjistron 393 vdekje më shumë se sa lindje.

Në tremujorin e parë 2023, katër qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në tetë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e parë 2023, qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 581 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Korça, me 265 vdekje më shumë se sa lindje.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T1 – 2023**



** Të dhëna janë paraprake

Lindjet

Gjatë vitit 2022, të gjitha qarqet e vendit shënuan ulje të numrit të lindjeve, në krahasim me vitin 2021.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve ishte Tirana me 9.089 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët ishte Gjirokastra me 392 lindje.

Rënien më të ulët në përqindje të lindjeve, gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021 e kishte qarku i Tiranës me 3,7 %, ndërsa rënien më të madhe e kishte qarku i Korçës me 23,0 %.

Në tremujorin e parë 2023, të gjitha qarqet e vendit shënojnë ulje të numrit të lindjeve, në krahasim me tremujorin e parë 2022.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 1.939 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 77 lindje.

Rënien më të ulët në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të parë 2023, krahasuar me tremujorin e parë 2022 e ka qarku i Kukësit me 8,9 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Lezhës me 33,2 %.

Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2021	2022	Ndryshimi vjetor në %	T1 - 2022	T1 - 2023**	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	27.211	24.688	-9,3	6.214	5.164	-16,9
1	Berat	1.050	930	-11,4	231	195	-15,6
2	Dibër	1.469	1.187	-19,2	283	229	-19,1
3	Durrës	2.976	2.733	-8,2	687	577	-16,0
4	Elbasan	2.392	2.185	-8,7	522	433	-17,0
5	Fier	2.377	2.062	-13,3	537	422	-21,4
6	Gjirokastrë	451	392	-13,1	111	77	-30,6
7	Korçë	1.647	1.269	-23,0	311	280	-10,0
8	Kukës	902	819	-9,2	190	173	-8,9
9	Lezhë	1.302	1.208	-7,2	322	215	-33,2
10	Shkodër	1.894	1.656	-12,6	405	347	-14,3
11	Tiranë	9.437	9.089	-3,7	2.286	1.939	-15,2
12	Vlorë	1.229	1.158	-5,8	329	251	-23,7
	*Të panjohur	85	0		0	26	

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.¹

** Të dhëna janë paraprake

Vdekjet

Gjatë vitit 2022, të gjitha qarqet e vendit shënuan ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me vitin 2021.

Qarku me numrin më të lartë të vdekjeve ishte Tirana me 5.827 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të ulët ishte Kukësi me 541 vdekje.

Rënien më të ulët në përqindje të vdekjeve, gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2021 e kishte qarku i Kukësit me 11,3 %, ndërsa rënien më të madhe e kishte qarku i Vlorës me 25,5 %.

Në tremujorin e parë 2023, të gjitha qarqet e vendit shënojnë ulje të numrit të vdekjeve, në krahasim me tremujorin e parë 2022.

Qarku me numrin më të lartë të vdekjeve është Tirana me 1.358 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Kukësi me 132 vdekje.

Rënien më të ulët në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të parë 2023, krahasuar me tremujorin e parë 2022 e ka qarku i Kukësit me 15,9 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Vlorës me 39,9 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2021	2022	Ndryshimi vjetor në %	T1 - 2022	T1 - 2023**	Ndryshimi tremujor në %
	Shqipëria	30.507	23.998	-21,3	8.119	5.557	-31,6
1	Berat	1.680	1.266	-24,6	430	291	-32,3
2	Dibër	1.084	947	-12,6	298	227	-23,8
3	Durrës	2.787	2.251	-19,2	766	532	-30,5
4	Elbasan	2.865	2.405	-16,1	821	542	-34,0
5	Fier	3.593	2.730	-24,0	927	617	-33,4
6	Gjirokastrë	1.043	836	-19,8	282	214	-24,1
7	Korçë	2.726	2.228	-18,3	697	545	-21,8
8	Kukës	610	541	-11,3	157	132	-15,9
9	Lezhë	1.351	1.139	-15,7	394	261	-33,8
10	Shkodër	2.484	2.003	-19,4	686	448	-34,7
11	Tiranë	7.795	5.827	-25,2	2.027	1.358	-33,0
12	Vlorë	2.451	1.825	-25,5	634	381	-39,9
	<i>*Të panjohur</i>	38	0		0	9	

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

** Të dhëna janë paraprake

Anekse

Tab. 3 Lindjet - tremujorët

Nr.	Qarku	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22	I - 23**
	Shqipëria	6.214	5.577	6.555	6.342	5.164
1	Berat	231	208	267	224	195
2	Dibër	283	295	308	301	229
3	Durrës	687	608	707	731	577
4	Elbasan	522	482	618	563	433
5	Fier	537	442	536	547	422
6	Gjirokastër	111	88	96	97	77
7	Korçë	311	315	342	301	280
8	Kukës	190	195	227	207	173
9	Lezhë	322	265	309	312	215
10	Shkodër	405	374	443	434	347
11	Tiranë	2.286	2.059	2.402	2.342	1.939
12	Vlorë	329	246	300	283	251
	*Të panjohur	0	0	0	0	26

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.

** Të dhëna janë paraprake

Tab. 4 Vdekjet - tremujorët

Nr.	Qarku	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22	I - 23**
	Shqipëria	8.119	5.066	5.429	5.384	5.557
1	Berat	430	289	274	273	291
2	Dibër	298	227	222	200	227
3	Durrës	766	478	507	500	532
4	Elbasan	821	525	536	523	542
5	Fier	927	599	583	621	617
6	Gjirokastër	282	178	186	190	214
7	Korçë	697	506	493	532	545
8	Kukës	157	106	145	133	132
9	Lezhë	394	226	255	264	261
10	Shkodër	686	429	490	398	448
11	Tiranë	2.027	1.142	1.319	1.339	1.358
12	Vlorë	634	361	419	411	381
	*Të panjohur	0	0	0	0	9

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.

** Të dhëna janë paraprake

Tab. 5 Shtesa natyrore e popullsisë - tremujorët

Nr.	Qarku	I - 22	II - 22	III - 22	IV - 22	I - 23**
	Shqipëria	-1.905	511	1.126	958	-393
1	Berat	-199	-81	-7	-49	-96
2	Dibër	-15	68	86	101	2
3	Durrës	-79	130	200	231	45
4	Elbasan	-299	-43	82	40	-109
5	Fier	-390	-157	-47	-74	-195
6	Gjirokastrë	-171	-90	-90	-93	-137
7	Korçë	-386	-191	-151	-231	-265
8	Kukës	33	89	82	74	41
9	Lezhë	-72	39	54	48	-46
10	Shkodër	-281	-55	-47	36	-101
11	Tiranë	259	917	1.083	1.003	581
12	Vlorë	-305	-115	-119	-128	-130
	*Të panjohur	0	0	0	0	17

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve/vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkutku është regjistruar lindja/vdekja mungon.

** Të dhëna janë paraprake

Tab. 6 Shtesa natyrore e popullsisë

Nr.	Qarku	2021	2022
	Shqipëria	-3.296	690
1	Berat	-630	-336
2	Dibër	385	240
3	Durrës	189	482
4	Elbasan	-473	-220
5	Fier	-1.216	-668
6	Gjirokastrë	-592	-444
7	Korçë	-1.079	-959
8	Kukës	292	278
9	Lezhë	-49	69
10	Shkodër	-590	-347
11	Tiranë	1.642	3.262
12	Vlorë	-1.222	-667
	*Të panjohur	47	0

* Kategoria "Të panjohur" nënkupton rastet për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja dhe/ose vdekja mungon.

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).